




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor me HANDIKOS-in dhe Kryqin e Kuq

Dëgjimi me qytetarë është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për qytetarë për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Uebfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimet:

UEBFAQE:

FACEBOOK:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=883595960469404&set=pcb.883596080469392>

PLATFORMA E KONSULTIMEVE PUBLIKE:

Me **03.07.2024** dëgjimi publik është mbajtur me HANDIKOS-in dhe Kryqin e Kuq duke filluar nga ora **10:15**.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Drejtori për Investime Kapitale, Blerim Morina, Zyrtari Kryesor Financiar, Naser Hashani, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore.

Drejtoresha Ardita Dërmaku ka hapur këtë dëgjim: Arsyeya kryesore e këtij takimi është që përmes juve t'i marrim projektet prioritare që mendoni se janë të rëndësishme për juve si OJQ dhe ato më me prioritet t'i vendosim në listën e projekteve për vitin 2025. Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00euro ku do të ketë një rritje prej 5.10%, krashasuar me vitin 2024, ku pjesa e dedikuar për investimeve kapitale arrin shumën 2.6 milion,

ndërsa pjesa për subvencione arrin shumën 885,000.00 euro. Nga ju pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres që përmes prioriteteve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju i konsideroni më të rëndësishme. Do të kemi rritje edhe në investime kapitale ka rritje rreth 100%, si dhe në subvencione kemi rritje në 650 mijë. Pjesa e subvencioneve ju intereson juve ndoshta edhe më shumë.

Zyrtari Kryesor Financiar, Naser Hashani: Çështjet e OJQ-ve desha të bëjë një krahasim në shpërndarjen e subvencioneve për vitin 2022 ku është 175 mijë, dhe nga kjo shumë u janë shpërndarë 34 OJQ-ve në nivel komune. Në këtë formë buxhetin për vitin 2024 do të ketë rritje dhe në bazë të thirrjes publike për projektet që kanë OJQ-të do të fitojnë shuma të caktuara në bazë të kategorive. Pra në krahasim me vitin 2023 do të ketë rritje të kategorisë për subvencione. Në OJQ-të mund t'i ndihmojmë vetëm në kuadër të subvencioneve e jo në kuadër të projekteve të OJQ-ve sepse nuk po na i pranon Ministria, pasi që nuk mund të jenë në kuadër të kategorive të Investimeve Kapitale.

Kërkesat e anëtarëve të HANDIKOS-it dhe Kryqit të Kuq ishin të ndryshme si:

Hyrmetë Morina, OJQ HANDIKOS: nevojat dhe kërkesat e tona janë jo të realizueshme disa, disa po na përkrahen deri në 6 muaj, deri në prill të viti 2024, ne jemi kanë keq, për vitin 2025 është mirë me u përkrah ne si Handikos për gjith vitin, sepse për këtë vitë për dy muaj do të mbesim keq për buxhet të viti 2025, është dhe qasja për personat me aftësi të kufizuara, mirë me u përkrah me tërë vitin me subvencione me kshyr komuna qysh është e mundshme, mos me met edhe ne keq. Ne kemi apliku me 22 janar kemi prituri deri me tash dhe na kanë thënë që nuk ka as komision asgjë, e di që edhe ju e keni me koh. Në objektin që jemi është ambient shumë i keq, jemi në vend të keq, ne kemi bërë kërkesa po ende as një përgjigje nuk kemi marrë. Kam biseduar edhe me kryetarin mirepo me ka thënë, se ne si komun nuk na lejohet me ndreq objekt për OJQ-të. Qasje nuk ka napër shkollë, tualete na kemi majt edhe takime me drejtorit që kurë të planifikohen për renovime ose regullimin e objekteve të planifikohet edhe qasja në tualete për personat me aftësi të kufizuara, shtëpit e shendetiti nuk i kanë kushtet, i kanë qasjet shumë të pjerrta. Kur të ndreqen gjanat duhet me pas ni qasje dhe takime me neve, toaletet janë edhe të vogla dhe nuk janë të përshtatshme, nuk mundesh as me karroc me hy. Janë inxhinjerat dhe

duhet diskutim. Kërkesa e parë Objekti, e dyta buxheti për ekzistim të shoqatës përmes subvencioneve, janë të nvojshme pra qasja, objekti dhe qëndrueshmëria e handikosit. Janë drejtorit tjera qe duhet të i marin parasysh kerkesat e personave me aftesi te kufizuara.

Shejnaze Fazliu HANDIKOS: Në shtëpin e kulturës nuk është e rregullar mire sepse ajo pjesë është shumë e ngushtë ku po ndërtohet qasja për persona me aftësi të kufizuara, une ja kam dërguar dimenzinet dhe vendi se ku duhet të bëhet qasja mirëpo nuk i kanë marë parasyshë.

Hyrmete Morina, OJQ HANDIKOS: mirë që është bërë qasja për personat me aftësi të kufizuara, mirëpo kur nuk i plotëson kushtet, po është shumë keq, po ndërtohen, po ipen paret mirëpo nuk po ka mundësi me u shfrytëzu, mos merrni vendime vetmas pa na konsultuar neve, ne duhet me mendu që na duhet hapsirë si dhe inventari për ruajtjen e dokumenteve, mjetet ortopedike etj.

Shejnaze: Me kshyr dhe donacion për mjete ortopedike të cilat mungojn, më shumë karroca, kubza, toalete. Sepse ne po ballafaqohemi me ta por ne nuk i kemi në dispozicion, ne mujme me ba zgjidhjen për antart e tone mire po ne nuk mujmë edhe per qytetaret tjerë nuk kem mundesi.

Drejtoresha: sa i përket ndrrimit të objektit ne kemi bërë kërkes në prishtin te Posta e Kosoves për tek posta në Kamenicë, mirëpo kanë thënë se investimi për rregullimin e objektit duhet me u kry drejtpërdrejt nga komuna, mirëpo ne nuk kemi të drejt si komun me investu në objekte të tjera. Kemi bërë kërkes për me marë me qera objektin mbrapa postës, për me ua mundësu juve dy zyre si dhe tualeti. Ne pa u konsultuar me juve paraprakisht nuk mund të marim vendime.

Hyrmete Morina, OJQ HANDIKOS: kamë kërkuar edhe një depo të bëhet për mjetet ortopedike dhe që të kemi qasje vetem ne ose edhe kto montazhet që po bëhen. Tek palestra është bërë një komision. Pastaj u mbyll dhe ne e kemi lan sepse uuk kemi pasë qasje për shërbim. Ta kemi nje objekt tonin një depo tonen, neve nuk na duhen vetëm zyre neve na duhet të kemi edhe salla për fëmi, depo e shum sene të tjera.


	Propozuesi	Propozimi	Formë e Kontaktit
1.	Hyrmete Morina	Rregullimi i objektit, Subvencione për HANDIKOS	Me telefon

		Qajsa e personave me aftësi të kufizuara, në objektet publike, shkollore, Paisje me mjete ortopedike, si karroca, tualete dhe kubza.	
2.	Shejnaze Fazliu	Donacione për mjetet ortopedike.	Me telefon

Të gjitha këto kërkesa të këtyre OJQ-ve janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkorporohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga anëtarët e OJQ-ve, takimi ka mbaruar në orën 10:30.


Procesmbajtëse:
Samire Krasniqi

 _____



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes së qytetarëve për dëgjimin buxhetor me HANDIKOS

Data: 03.07.2024

Ora: 10:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatësia etnike	Nënshkrimi ¹²
1.	HSRNETE ABRINA			F	SH	
2.	SHEJNAZE FAZILU			F	SH	
3.	VEORA ISUFI			F	SH	
4.						
5.						
6.						
7.						
8.						

¹ SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. **SRB:** Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografirše i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampar.

² SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përpunoj të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. **SRB:** Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obraduje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.